REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ Prot. _____ Kavajë më __ .___. 2026

PROJEKT – VENDIM

DATË _____ / _____ / 2026

Për

Dhënien e titullit "QYTETAR NDERI" i Kavajës aktorit dhe regjizorit Z. ESAT TELITI

me këtë motiviacion:

"Për kontributin e vyer dhe të qëndrueshëm në artin skenik shqiptar, interpretimin dhe regjizurën me nivel të lartë profesional, formimin e brezave të rinj të artistëve, si dhe për promovimin dhe përfaqësimin me dinjitet të kulturës kavajase dhe shqiptare në skenat teatrore dhe artistike brenda dhe jashtë vendit."

Në mbështetje të nenit 54, germa "m", dhe Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", në Ligjin 8480, date 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në Ligjin Nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit ne Republikën e Shqiperisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqiperisë", në Kodin e Procedurave Administrative, në mbledhjen e radhës, Kryetari i Bashkisë Kavajë i kërkon Këshillit të Bashkisë Kavajë:

VENDOSI:

Dhënien e titullit "QYTETAR NDERI" i Kavajës aktorit dhe regjizorit Z. ESAT TELITI

me këtë motiviacion:

"Për kontributin e vyer dhe të qëndrueshëm në artin skenik shqiptar, interpretimin dhe regjizurën me nivel të lartë profesional, formimin e brezave të rinj të artistëve, si dhe për promovimin dhe përfaqësimin me dinjitet të kulturës kavajase dhe shqiptare në skenat teatrore dhe artistike brenda dhe jashtë vendit."

DREJTORIA E KULTURËS DHE SPORTEVE

GENTIAN JAUPI

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ADRIAN MALAJ

ZV/KRYETAR I BASHKISË

GENCI GJYLSHENI

DREJTORIA LIGJORE

HELIDON PLAKU

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

MERI BITURKU

KRYETARI I BASHKISË

FISNIK QOSJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KAVAJË

Nr _____ Prot

Kavajë më ___ / ___ /2026

PROPOZIM

Për:

Dhënie e titullit "QYTETAR NDERI" aktorit dhe regjisorit të mirënjohur ESAT TELITI

Unë, Z. Fisnik Qosja, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, propozoj dhënien e titullit "Qytetar Nderi" për aktorin dhe regjisorin e mirënjohur Esat Teliti, për kontributin e tij të shquar dhe të vazhdueshëm ndër vite në artin skenik shqiptar, si dhe për ngritjen dhe promovimin e emrit të qytetit të Kavajës në skenën kombëtare të kulturës dhe artit. Esat Teliti, me origjinë nga Kavaja, është një nga figurat më përfaqësuese të teatrit dhe kinematografisë shqiptare. Me një karrierë të gjatë dhe të pasur si aktor dhe regjisor, ai ka interpretuar dhe vënë në skenë dhjetëra role e vepra që kanë lënë gjurmë të thella në jetën kulturore të vendit. Profesionalizmi, serioziteti artistik dhe përkushtimi i tij ndaj artit e kanë bërë Esat Telitin një emër të respektuar dhe të vlerësuar nga publiku dhe kritika.

Përmes veprimtarisë së tij artistike, Esat Teliti ka kontribuar jo vetëm në zhvillimin e artit skenik shqiptar, por edhe në edukimin estetik të brezave të rinj, duke u shndërruar në një model frymëzimi dhe përfaqësimi dinjitoz të qytetit të Kavajës. Në vlerësim të kontributit të tij të jashtëzakonshëm në kulturë, art dhe në promovimin e identitetit qytetar të Kavajës, dhënia e titullit "Qytetar Nderi" për Esat Telitin përbën një vlerësim të merituar dhe një nder për komunitetin tonë.

KRYETARI I BASHKISE

FISNIK QOSJA

RELACION

e propozim të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, z. **Fisnik Qosja**, nisur nga kontributet e htëzakonshme që ka dhënë për qytetin e Kavajës dhe në nivel kombëtar në fushën e **teatrit e kinematografisë**, si **aktor dhe regjisor i shquar**, për talentin e tij të veçantë artistik, ofesionalizmin dhe përkushtimin shumëvjeçar në skenë, si dhe për rolin e rëndësishëm në ukimin estetik dhe kulturor të publikut, duke nderuar vazhdimisht vendlindjen e tij, **Drejtoria Kulturës dhe Sporteve** i propozon **Këshillit Bashkiak Kavajë**:

hënien e titullit "QYTETAR NDERI" i Kavajës aktorit dhe regjizorit Z. ESAT TELITI

me këtë motivacion:

"Për kontribution e vyer dhe të qëndrueshëm në artin skenik shqiptar, interpretimin dhe regjizurën me nivel të lartë profesional, formimin e brezave të rinj të artistëve, si dhe për promovimin dhe përfaqësimin me dinjitet të kulturës kavajase dhe shqiptare në skenat teatrore dhe artistike brenda dhe jashtë vendit."

ESAT TELITI është një nga figurat më përfaqësuese të artit skenik shqiptar, i lidhur ngushtë me qytetin e Kavajës, ku ka ushtruar dhe zhvilluar një veprimtari të gjatë artistike dhe kulturore. Që në fillimet e tij, ai u dallua për talentin interpretues, seriozitetin profesional dhe pasionin e veçantë për teatrin. Gjatë karrierës së tij shumëvjeçare, Esat Teliti ka interpretuar dhe ka vënë në skenë një numër të konsiderueshëm rolesh dhe shfaqjesh teatrore, duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit të Kavajës dhe më gjerë. Ai ka qenë një bashkëpunëtor i rëndësishëm i institucioneve kulturore vendore, duke ndihmuar në ngritjen e trupave teatrore, organizimin e aktiviteteve artistike dhe pasurimin e repertorit skenik.

Si regjisor, Esat Teliti është shquar për vizion artistik, përzgjedhje tematike me vlera shoqërore dhe njerëzore, si dhe për aftësinë për të përcjellë mesazhe të forta përmes gjuhës së teatrit. Veprat e tij janë karakterizuar nga ndjeshmëria, realizmi artistik dhe lidhja e fortë me realitetin shoqëror shqiptar. Një kontribut i veçantë i Esat Telitit lidhet me **formimin dhe edukimin e brezave të rinj**, të cilëve u ka transmetuar jo vetëm teknikat e artit skenik, por edhe vlerat etike, disiplinën profesionale dhe dashurinë për kulturën dhe artin kombëtar. Për shumë artistë të rinj, ai ka qenë dhe mbetet një figurë frymëzuese dhe orientuese.

Figura artistike dhe qytetare e Esat Telitit ka gëzuar gjithmonë respektin dhe vlerësimin e publikut, kolegëve dhe institucioneve kulturore. Ai është konsideruar si një ndër personalitetet që ka kontribuar në ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e traditës teatrore në Kavajë, duke e bërë këtë qytet pjesë të rëndësishme të hartës kulturore shqiptare.

DREJTORI

GENTIAN JAUPI